

10

VJET

ASIG
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

14-16 Nëntor 2023

NDIQNI AGJENDËN

GISday

Workshop-i me temë “Integrimi i të dhënave gjeohapësinore dhe statistikore”

Përfaqësues të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor morën pjesë në Workshopin e organizuar nga UNECE, Eurostat dhe UN-GGIM Europe, me temë “Integrimi i të dhënave gjeohapësinore dhe statistikore”, i cili u zhvillua më 04-05 Tetor 2023, në Beograd. Ky workshop ishte i fokusuar në prezantimin dhe ndarjen e praktikave inovative, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive kombëtare gjeohapësinore dhe statistikore, në promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar duke përdorur standarde të përbashkëta, si dhe identifikimin e fushave për bashkëpunimet e ardhshme.



Workshop-i i 4-ët ndërkombëtar me temë “Cilësia e të dhënave gjeohapësinore”

Në workshop-in e 4-ët ndërkombëtar për “Cilësinë e të dhënave gjeohapësinore” i cili u zhvillua më 11 - 12 Tetor 2023, në Bruksel, nga EuroGeographics dhe EuroSDR, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), nga Sektori i Standardeve për Gjeoinformacionin.

Qëllimi i këtij workshop-i ishte njohja e pjesëmarrësve me praktikën më të mira për rritjen e besueshmërisë së burimit të të dhënave gjeohapësinore dhe cilësisë së tyre.

Përfaqësuesit e ASIG në prezantimin e tyre sollën për të pranishmit informacion mbi cilësinë e të dhënave gjeohapësinore, mënyrën se si kontrollohen këto të dhëna, software-ët që përdoren, si dhe objektivat e së ardhmes mbi rritjen e sigurtisë së të dhënave gjeohapësinore.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Një udhëzues për llogaritjen e të dhënave vëllimore me drone

Dronët kanë revolucionarizuar industri të ndryshme duke patur një ndikim të rëndësishëm edhe në matjen e të dhënave vëllimore. Me aftësinë e tyre për të kapur imazhe të sakta dhe të detajuara ajrore, dronët kanë sjellë ndryshime në qasjen e llogaritjes së të dhënave vëllimore. Në këtë udhëzues, do të eksplorojmë përfitimet e përdorimit të teknologjisë së dronëve për matjen e të dhënave vëllimore, metodat e ndryshme të disponueshme dhe mënyrën e matjes së saktë të të dhënave vëllimore me UAV.

Të rejat në ArcGIS Online - Tetor 2023

ArcGIS Online ju lejon të njihni botën përreth jush duke përdorur harta interaktive për të lidhur njerëzit, vendndodhjet dhe të dhënat gjeohapësinore. Përditësimi i fundit i këtij software, përfshin funksione të reja në Map Viewer, të tilla si mjete shpesh të analizës dhe funksione raster, cilësime të zonës kohore, si dhe përmirësime të tjera dhe aftësi të reja në ArcGIS Online.

AKTIVITETE NË VIJIM

EU Space Week 2023

Java e Hapësirës së BE-së 2023, mbledhja kryesore për komunitetin evropian të hapësirës, është caktuar të mbahet në Sevilla, Spanjë, nga 7 deri më 9 nëntor 2023. Komisioni Evropian dhe Agjencia e BE-së për Programin Hapësinor (EUSPA), në bashkëpunim me Presidencën spanjolle të Këshillit të BE-së, organizojnë bashkërisht këtë aktivitet.

7-9 Nëntor 2023

www.asig.gov.al

Aktivitet në kuadër të 10-vjetorit të ASIG dhe Ditës së GIS Ndërkombëtar

Në kuadrin e 10 - vjetorit të themelimit të institucionit, stafi i ASIG do të organizojë një javë aktivitetesh me fokus arritjet e deritanishme, planet dhe pritshmëritë për të ardhmen si dhe vizionin për të ofruar produkte inovatore duke përdorur teknologjinë dhe imazheritë inteligjente.

14-16 Nëntor 2023

Geodata Discoverability Online Workshop

Eurogeographics dhe EuroSDR organizojnë së bashku një workshop të dytë online të zbulueshmërisë së të dhënave gjeohapësinore. Ky workshop synon shkëmbimin e përvojave praktike, gjetjeve dhe udhërrëfyesve në lidhje me zbulueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore.

16-17 Janar 2024

www.geoportal.asig.gov.al